

Thirrja nga data 09.06.2026 deri në datën 15.06.2026

TERMAT E REFERENCES

PËR

TRAJNER/E PËR OFRIMIN E TRAJNIMIT PËR ASAMBLENË KOMUNALE TË FËMIJËVE DHE GRUPI HËNA, MBI TEMËN "TË GJITHË JEMI TË BARABARTË"

Organizata	OJQ "NEVO KONCEPTI"
Objektiva	Zhvillimi dhe ofrimi i trajnimit në temën "Të Gjithë jemi të Barabartë" për anëtarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF) dhe Grupin Hëna.

OJQ "Nevo Koncepti" është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ "Nevo Koncepti" kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ "Nevo Koncepti" bashkëpunon me fëmije, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

OJQ Nevo Koncepti nga viti 2022 të muajit Qershor ka filluar të zbatojë projektin "Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve" në Komunën e Prizrenit, asambleja përbëhet nga 45 antarë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat e mesme të ulëta të komunës së Prizrenit. Në Asamblenë Komunale të Fëmijëve janë të përfshirë komunitetet Rom, Shqiptar, Turk, Boshnjak, Ashkali dhe Egjiptian, gjithashtu në Asamblenë Komunale të Fëmijëve përfaqësohen edhe fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të cilat organizohen nga antarët e Asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Aktualisht OJQ "Nevo Koncepti" është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHMË RRETH PROJEKTIT

"Qeverisja e të Drejtave të Fëmijëve" është projekt i implementuar nga Nevo Koncepti në partneritet me Save the Children Kosova/o dhe financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida). Qëllimi i projektit është avokimi për të drejtat e fëmijëve dhe ngritja e pjesëmarrjes së fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal gjatë hartimit të politikave dhe gjatë organizimit të ngjarjeve nga komuna e Prizrenit nëpërmjet krijimit të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në nivel të komunës nga 13 shkollat fillore të mesme të ulëta të komunës së Prizrenit.

Asambleja Komunale e Fëmijëve të Prizrenit është krijuar në vitin 2017 dhe përbëhet nga 43 Asamblesitë të cilët përfaqësohen nga 13 shkollat. Asambleja ka për qëllim avokimin dhe mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

2. OBJEKTIVA

Të rritet ndërgjegjësimi dhe kuptimi i fëmijëve lidhur me konceptet e barazisë, përfshirjes dhe respektimit të diversitetit, duke promovuar vlerat e pranimit, solidaritetit dhe mundësive të barabarta për të gjithë. Përmes aktiviteteve interaktive dhe diskutimeve, fëmijët do të kenë mundësi të reflektojnë mbi rëndësinë e trajtimit të barabartë të secilit individ, pavarësisht dallimeve në aftësi, gjini, etni, gjuhë, status social apo karakteristika të tjera.

Aktiviteti synon të fuqizojë fëmijët që të bëhen promovues të përfshirjes dhe mosdiskriminimit në shkollat dhe komunitetet e tyre, duke nxitur empatinë, bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjellë.

Nevo Koncepti kërkon një individ (trajner/e) për të zhvilluar dhe fasilituar një trajnim njëditor me temën "Dita e Ndërgjegjësimit për Barazi dhe Përfshirje – Të Gjithë Jemi të Barabartë", me pjesëmarrjen e anëtarëve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve të Prizrenit dhe fëmijëve nga Grupi "Hëna". Aktiviteti do të krijojë një hapësirë të sigurt dhe gjithëpërfshirëse ku fëmijët e moshës 12–15 vjeç do të mësojnë, bashkëpunojnë dhe ndajnë përvoja mbi rëndësinë e barazisë dhe përfshirjes në shoqëri.

3. Kualifikimi i kandidatit/ës

Trajneri/ja duhet të ketë aftësitë dhe njohurinë të nevojshme vijuese:

- Diplomë universitare në shkenca sociale, edukim, psikologji, pedagogji ose fusha të ngjashme;
- 5-7 vjet përvojë pune si trajner/e, duke përfshirë hartimin moduleve të trajnimit dhe ofrimin e programeve
- Njohuri të mira mbi të drejtat e fëmijëve, barazinë, përfshirjen sociale, mosdiskriminimin dhe pjesëmarrjen e fëmijëve;
- Përvojë në punën me fëmijë dhe të rinj, duke përdorur metoda interaktive dhe të përshtatura sipas moshës;
- Shkathtësi të mira komunikimi, organizative, të punës interaktive dhe qasje mësimore adaptive dhe dinamike për të siguruar që të mësuarit përshtatet nevojave të pjesëmarrësve
- Njohuri dhe shkathtësi për të komunikuar dhe punuar me fëmijë dhe të rinj
- Kreativ, i/e hapur, motivues dhe që pranon sugjerimet;
- Respekton afatet kohore
- Të jetë fleksibil për tu përshtatur me orarin e përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve (AKF), për të caktuar ditën e trajnimit.
- Të jetë i/e aftë në komunikim me fëmijët, t'i mësoj dhe këshillojë fëmijët mbi temën.
- Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit sa i përket respektimit të të drejtave të fëmijëve.
- Të ketë ekspertizë mbi temën e lartëcekur (kandidatët preferohet të kenë qertifikime mbi temën)
- Udhëheqë trajnimit me profesionalizëm, sqarojë dhe shtjellojë tematikën dhe termet përkatëse në pajtim me 9 rregullat për pjesëmarrje të sigurt dhe kuptimplotë të fëmijëve:
<https://resourcecentre.savethechildren.net/document/nine-basic-requirements-meaningful-and-ethical-childrens-participation/>

Të punojë në përputhje me politikat e Nevo Konceptit, sa i përket Politikës për mbrojtjen e fëmijëve mbi respektimin e të drejtave të fëmijëve.

4. AFATI KOHOR

Puna duhet të filloj me Dhjetor deri me 10 Shkurt 2026. Raporti duhet dorëzuar në gjuhën shqipe në përfundim të punës.

Numri i rezultatit	Titulli i rezultatit	Përshkrimi	Ditët e punës	Data e rezultatit
1	Përgatitja e programit të trajnimit	Zhvillimi / adaptimi i programit të trajnimit, përfshirë matricat e trajnimit, si dhe të formojë vlerësimin Pre Post Test	2	Qershor 2026
2	Ofrimi i programit të trajnimit për Asamblenë Komunale të Fëmijëve dhe Grupin Hëna	Ofrimi i trajnimit 1-ditor për një grup të pjesëmarrësve	1	Qershor 2026
3	Dorëzimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin	Hartimi i raportit përfundimtar mbi angazhimin në trajnimin	1	Qershor 2026
	Gjithsej:		4	

5. REZULTATET E PRITSHME

- Pjesëmarrësit do të njihen me konceptet kryesore të barazisë, përfshirjes, diversitetit, respektit dhe mosdiskriminimit.
- Rritja e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e barazisë dhe përfshirjes. Fëmijët do të kuptojnë rëndësinë e trajtimit të barabartë të të gjithë individëve dhe do të reflektojnë mbi ndikimin e diskriminimit dhe përjashtimit në jetën e fëmijëve dhe të rinjve.
- Zhvillimi i empatisë dhe respektit për diversitetin. Pjesëmarrësit do të forcojnë aftësinë për të kuptuar dhe respektuar dallimet ndërmjet individëve, duke promovuar pranimin dhe bashkëjetesën në shkollë dhe komunitet.
- Përmirësimi i aftësive të komunikimit dhe bashkëpunimit. Fëmijët do të zhvillojnë aftësi për të komunikuar në mënyrë pozitive, për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët dhe për të ndërtuar marrëdhënie të bazuara në respekt dhe mirëkuptim.
- Fuqizimi i fëmijëve si promovues të përfshirjes. Pjesëmarrësit do të identifikojnë mënyra konkrete për të promovuar barazinë dhe përfshirjen në shkollat, familjet dhe komunitetet e tyre, duke kontribuar në krijimin e mjediseve më gjithëpërfshirëse.
- Rritja e vetëbesimit dhe pjesëmarrjes aktive.

Fëmijët do të ndihen më të sigurt për të shprehur mendimet dhe përvojat e tyre, si dhe për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe të bashkëmoshatarëve.

- Nxitja e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Pjesëmarrësit do të zhvillojnë një kuptim më të mirë për rëndësinë e përfshirjes së plotë dhe të barabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, arsimore dhe komunitare.

- Krijimi i mesazheve dhe rekomandimeve nga fëmijët.

Në fund të aktivitetit, fëmijët do të zhvillojnë mesazhe dhe ide konkrete për promovimin e barazisë, respektit dhe përfshirjes në komunitetin e tyre.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Të gjithë të interesuarit duhet t'i dërgojnë këto dokumente:

- a) CV.
- b) Metodologjia e propozuar e mbajtjes së trajnimit.
- c) Dy (2) referencë.
- d) Dokument i cili dëshmon që aplikuesi/ja nuk është nën hetime.
- e) Oferten Financiare Bruto

Aplikimi duhet të dërgohet **jo më larg se data 15.06.2026** në prokurimi@nevokoncepti.org